



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 084/2026
Datë: 22.04.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (1.3 dhe 1.4), të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, me datën 22 prill 2026, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Agron Bajrami, Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, emërohet Kryenegociator i Republikës së Kosovës në dialogun teknik për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.
2. Funksioni i Kryenegociatorit nga pika 1 e këtij Vendimi, përfundon me mbarimin e mandatit të Kryeministrit, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
3. Kryenegociatori nga pika 1 e këtij Vendimi, është i obliguar të bëjë deklarin e pasurisë në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Jeton Zulfaj, Kryenegociator me BE;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.